



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TREGTISË
DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE ✓

Nr. 7637 Prot.

Tiranë, më 3 . 12 . 2014

Drejtuar: SH.A "BERATEKS"

BERAT

Lënda : Miratohet statuti i shoqërisë " Berateks " Berat.

Pasi shqyrtuam projekt statutin e paraqitur për miratim nga shoqëria " Berateks " Berat, konstatojmë se ai është hartuar në zbatim të dispozitave të nenit 230 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Për këto arsye bazuar në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të Ligjit Nr. 8237, datë 01.09.1997 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 7926, datë 20.04.1995 " Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare" ndryshuar me Dekretin nr. 1195, datë 14.08.1995, Ligjin Nr. 8158, datë 07.11.1996, ndryshuar me dekretin Nr. 3318, datë 30.04.2002, Ligjin Nr. 8885, datë 22.04.2002, nenit 216 e në vijim të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", aksionari shtet i cili zotëron 100% të aksioneve të Sh.a " Berateks" Berat, miraton statutin e ri të shoqërisë.

Ngarkohet Sh.a " Berateks " Berat, për kryerjen e veprimeve përkatëse në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" Seksioni III, Regjistrimi fillestar, neni 32,36.

ARBEN AHMETAJ



STATUTI I SHOQERISE
"BERATEX" SH.A. BERAT

Bazuar ne ligjin nr. 9901, date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"

KREU I

EMERTIMI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA

Neni 1

Forma dhe emertimi i shoqerise

- 1.1 Shoqeria anonime e krijuar ne baze te legjislacionit te Republikes se Shqiperise dhe emertohet shoqeria "Beratex" sh.a. Berat.
- 1.2 Shoqeria eshte organizuar dhe funksionon ne perputhje me dispozitat e ketij statute dhe ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", te ndryshuar.
- 1.3 Shoqeria ka stemen dhe vulen e saj.

Neni 2

Selia e shoqerise

- 2.1 Selia e shoqerise eshte: Godina e Kaldajes brenda ish-Kombinatit Tekstileve Berat.
- 2.2 Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregetise dhe Sipermarjtes (Asambleja e Pergjithshme) mund te ndryshoje seline e shoqerise, mund te caktojte ose te mbylle seli dytesore ne Shqiperi dhe jashte saj, mund te hapte veprimtari ose njesi te reja brenda dhe jashte vendit si dhe te shtojte apo pakesejoj objektin e shoqerise.

Neni 3

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jete per nje afat te pacaktuar.

KREU II

OBJEKTI

Neni 4

Objekti

- 4.1 Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte : Import-eksport dhe shitje-bletje me shumice dhe pakice te mallrave te ndryshme te industries tekstile, mekanike, etj.
- 4.2 Dhenia me qira apo shitja e aseteteve te shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi.
- 4.3 Shoqeria, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, do te kryejte cdo veprimtari tjeter qe lidhet drejtperdrejt ose terthoraz me objektin e parashikuar ne piken 4.1. Kjo perfshin gjithashtu zgjerimin e aktivitetit, krijimin e shoqerive te reja, si dhe pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera brenda dhe jashte vendit .

1

KREU III

KAPITALI THEMELTAR – AKSIONET

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise

- 5.1 Kapitali i Shoqerise eshte **196,174,900 leke** qe perbehet nga **196,174.9 aksione** me vlere nominale **1,000 (njemije) leke** secili.
- Ky kapital perbehet :
 - Trualli
 - Ndertesat,
 - Aktivitet afatgjatja material
 - Aktivitet afatshkurtra
- Kapitali eshte i ndare ne **196,174.9 aksione** te se njejtjes kategori. Aksionet jane te numeruara nga 1 deri ne **196,174.9 aksione**.
- 5.2 Pronari i vetem i aksioneve eshte shteti shqiptar I perfaqesuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregetise dhe Sipermarjtes.

Neni 6

Ndryshimi i kapitalit dhe transferimi i aksioneve

- 6.1 Ndryshimi i kaitalit te shoqerise dhe transferimi i aksioneve ne rastin e privatizimit , mund te behet vetem me vendim te Asamblese se Aksioneve, ne baze te raportit te Administratorit te Shoqerise te hartuar ne perputhje me dispozitat e ligjit nr.9901, date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".
- 6.2 Persa kohe qe aksioneri i vetem i shoqerise eshte shteti shqiptar I perfaqesuar nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregetise dhe Sipermarjtes, veprimet e mesiperme do te kryhen vetem me Urdhr te Tij.

KREU IV

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

KESHILLI MBIKQYRES

Neni 7

Organet drejtuese te shoqerise

Organet drejtuese te shoqerise jane :

1. Keshilli Mbiqyres
2. Administratori

Neni 8

Perberja dhe emerimi i anetareve te Keshillit Mbiqyres

- 8.1 Keshilli Mbiqyres perbehet nga jo me shume se 3 (tre) anetare .Anetaret e keshillit Mbiqyres emerohen nga Ministri I Zhvillimit Ekonomik, Tregtise dhe Sipermarjtes(Asambleja e Pergjithshme) ne perputhje me kriteret e percaktuara ne akte nenligjore.
- 8.2 Kohezgjatja e funksionit te anetarit te Keshillit Mbiqyres eshte 3 (tre) vjet. Anetaret e Keshillit Mbiqyres jane te rizgjedhshem. Ata mund te shkarohen ne cdo moment nga Ministri i

2

Zhvillimit Ekonomik, Tregetise dhe Sipermarjtes (Asambleja).

- 8.3 Anetaret e Keshillit Mbiqyres jane individ. Ata nuk mund te jene te punesuar ne shoqeri.
- 8.4 Anetaret e Keshillit Mbiqyres nuk mund te bejne pjese ne me shume se 2 (dy) Keshilla te shoqerive qe e kane seline ne Republikën e Shqiperise.
- 8.5 Ne rast vdekje, lirimi nga detyra, apo dorचेeje, vendi vakant duhet te zevendesohet qe me vone se 3 (tre) muaj. Anetari i emeruar per te zevendesuar nje anetar te Keshillit Mbiqyres, ploteson kohen e mbetur te mandatit trevjecar te parardheshit.
- 8.6 Anetaret e Keshillit Mbiqyres te moshes mbi 65-vjec nuk mund te jene me shume se 1/3 e numerit te pergjithshem te anetareve te Keshillit Mbiqyres. Nese ky raport tejkalohet, anetari me i vjeter eshte i liruar zyrtarisht nga detyra.

Neni 9

Kryetari dhe nenkryetari i Keshillit Mbiqyres

- 9.1 Keshilli Mbiqyres emeron midis anetareve te tij Kryetarin dhe Nenkryetarin te cilet kane si detyre thirrjen e mblendhjeve te Keshillit te tyre dhe drejtimin e diskutimeve. Ata emerohen per te gjitha kohezgjatjet e mandatit te tyre dhe mund te rizgjidhen.
- 9.2 Kryetari dhe nenkryetari i Keshillit Mbiqyres jane individe. Ata ushtrojne funksionet e tyre gjate gjithë periudhes se mandatit trevjecar. Ne rast lirimi, i rizgjedhuri ploteson mandatit e paraardheshit.
- 9.3 Keshilli Mbiqyres mund te caktojte nje sekretar/re dhe jashte anetareve te tij.
- 9.4 Ne rast mungese te Kryetarit, mblendhjet e Keshillit do te drejtohen nga Nenkryetari.

Neni 10

Mblendhjet dhe vendimet e Keshillit Mbiqyres

- 10.1 Keshilli Mbiqyres mblidhet rregullisht te pakten nje here ne tre muaj si dhe sa here qe e kerkon interesi i shoqerise, me kerkese te Kryetarit, ose ne mungese te tij, nga Nenkryetari.
- 10.2 Kryetari therrret Keshillin Mbiqyres, brenda 15-ditesh nga kerkesa e motivuar e Administratorit te shoqerise, ose e 1/3 e antareve te Keshillit Mbiqyres. Nese kerkesa mbetet pa pergjigje, atehere kerkuesit mund te therrasin mblendhjen e Keshillit Mbiqyres duke percaaktuar rendin e dites.
- 10.3 Thirrja behet 3 (tre) dite perpara mblendhjes, me ane te nje letre, telegrami, teleteks apo faks. Thirrja do te quhet e vlefshme edhe nese komunikohet gojarisht dhe pa respektuar afatin kohor ne rast se anetaret e Keshillit Mbiqyres e pranajojne ate.
- 10.4 Cdo thirrje permban rendin e dites, daten, oren dhe vendin e zhvillimit te mblendhjes.Mblendhjet e Keshillit Mbiqyres zhvillohen zakonisht ne seline e shoqerise ose ne cdo vend tjeter qe do te percaktohet ne njoftimin e mblendhjes.
- 10.5 Rendi i dites se mblendhjes caktohet nga Kryetari i Keshillit Mbiqyres mund te programit vjetor te aktivitetit te tij, te miratur ne fillim te vitit. Keshilli Mbiqyres baze te shqyrtojte edhe probleme te tjera te rendesishme qe propozohen gjate vitit nga anetaret e Keshillit Mbiqyres ose nga Administratori.
- 10.6 Per cdo mblendhje te Keshillit Mbiqyres, ne nje regjister te vecante, mbahet procesverbali i cili nenshkruhet nga Kryetari. Ne te pasqyrohen:
 - data dhe vendi i mblendhjes,
 - menyra e thirrjes, pjesemarrjesit,
 - rendi i dites, drejtuesin e mblendhjes,
 - perrmbledhje te dokumentave dhe raporteve qe do te diskutohen,
 - perrmbledhje te diskutimeve te pjesemarrvesve,
 - rezultati i votimit dhe vendimet qe merren.

3

- 10.7 Vendimet qe merren ne mblendhjen e Keshillit Mbiqyres ne pajtim me dispozitat ligjore ne fuqi te evidentuara sipas proces-verbalit, nenshkruhen nga Kryetari.
- 10.8 Keshilli Mbiqyres nuk mund te merrte vendime te vlefshme pa qene te pranishem me shume se 1/2 e anetareve te tij.Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem. Ne rast numer votash te barabarta, vota e Kryetarit mbizoteron.
- 10.9 Keshilli Mbiqyres mund te organizoje gjithashtu mblendhje dhe te marre vendime te thjeshte me shumice te thjeshte votash nepermjet komunikimeve me shkrim, faks, poste elektronike dhe sherbime postare
- 10.10 Keshilli Mbiqyres, nese e shleh te arsyeshme, mund te therrase ne mblendhjen e tij Administratorin, ekspertet kontabel te miratur ose pale te trata per qellime keshillimi.

Neni 11

Kompetencat e Keshillit Mbiqyres

- 11.1 Keshilli Mbiqyres ushtron kontroll te vazhdueshem ndaj Administratorit per administrimin e shoqerise nga ana e tyre. Ai i jep ketyre te fundit autorizimin per te kryer operacione qe nuk mund te kryen nga Administratori pa autorizimin e Keshillit Mbiqyres.
- 11.2 Keshilli Mbiqyres ka te drejte te verifikojte dhe kontrolloje ne cdo kohe dokumentacionin qe e gjykon te nevojshem per permbledhjen e gjithë detyrave te tij. Ne cilesine e organit mbiqyres, keqyr venien ne zbatim te politikave tregtare dhe perputhjen e tyre me ligjin dhe statutin.
- 11.3 Keshilli Mbiqyres percakton numrin e administratorëve, emerohen dhe shkaron ata me shumice te thjeshte votash dhe ndan kompetencat ndermjet tyre.
- 11.4 Keshilli Mbiqyres apo Asambleja se Pergjithshme mund te shkarkoje ne cdo kohe secilin prej administratorëve me shumice te thjeshte votash.
- 11.5 Me emerimin e administratorëve, Keshilli Mbiqyres lidh kontrate me ta per detyrimet qe rrjedhin per administrimin e shoqerise.
- 11.6 Miraton programin vjetor te zhvillimit ekonomiko-financiar dhe te auditimit te brendshem dhe analizon e kontrollon zbatimin e tyre. Ne cdo tre muaj, ne menyre te perrnblendhur, informon Ministrine e Zhvillimit Ekonomik, Tregetise dhe Sipermarjtes (Asamblene e Pergjithshme), per permbushjen e programeve dhe problemet e paraqitura. Verifikon dhe kontrollon, llogarite vjetore dhe raportet perkatese te ekspertit kontabel te autorizuar.
- 11.7 Keshilli Mbiqyres, ne perputhje me aktet ligjor ne fuqi, miraton shperblimin e punonjesve te shoqerise dhe shqyrton e miraton propozimet per sponsorizime qe i paraqiten nga Administratori.
- 11.8 Keshilli Mbiqyres percakton vleren e kontratave per te cilen Administratori perpara se ta lidhe eshte i detyruar te marre autorizimin e Keshillit Mbiqyres.
- 11.9 Keshilli Mbiqyres kujdeset qe shoqeria te respektojte ligjin dhe standartet e kontabilitetit, si dhe siguron qe pasqyrat financiare, raportet e ecurise se veprimtarise si dhe detyrimet e tjera te raportimit dhe publikimit, te detyrueshme ne baze te ligjit apo statutit, te kryhen me saktesi nga administratori.
- 11.10 Keshilli Mbiqyres i propozon zhvillimit Ekonomik, Tregetise dhe Sipermarjtes (Asamblese e Pergjithshme) lirin me keto vendime:
 - Percaktimin dhe ndryshimin e programit te veprimtarise afatshkurter, afatmesem dhe afatgjate te shoqerise.
 - Kryerjen e investimeve dhe financimeve per vitin financiar si dhe masat e tjera qe do te kerkojnen ndryshimin e kapitalit themeltar te shoqerise.
 - Hapjen e veprimtarive ose njesive te reja tregtare brenda apo jashte vendit si dhe ndryshimin e objektit te shoqerise.

4

- Shitjen e pasurive qe perbejne aktivin e qendrueshem te shoqerise.
- Themelimen e shoqerive tregtare/grupeve te reja dhe/ose pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera vendase apo te huaja.
- Marjen e huave afatmesme dhe afatgjate.
- Si dhe per cdo ceshtje tjeter qe ne baze te Ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" eshte kompetence e Asamblese se Pergjithshme.

Neni 12

Shperblimi i anetareve te Keshillit Mbiqyres

- 12.1 Shperblimi i anetareve te Keshillit Mbiqyres do te behet ne perputhje me kriteret e percaktuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave .

KREU V

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 13

Administratori

- 13.1 Shoqeria drejtohet nga Administratori i cili eshte person fizik. Numri i administratorëve caktohet nga Keshilli Mbiqyres. Me shumice te thjeshte votash Keshilli Mbiqyres, emerohet Administratorin. Administrator i shoqerise do te jete z.Gramoz Hazizolli, I datelindjes 08.04.1960, me leternjoftim nr.G00408226Q.
- 13.2 Ne vendimin e emerimit, percaktohet edhe paga e administratorit ne perputhje me aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi.
- 13.3 Administratori eshte person fizik, ne te kundert emerimi i tij eshte i pavlefshem. Kohezgjatja e mandatit te Administratorit eshte 3 vjet. Zevendesuesi ploteson mandatin e paraardheshit. Nese nje anetar i Keshillit Mbiqyres emerohet administrator, mandati i tij ne Keshillin Mbiqyres perfundon. Nje person nuk mund te jete administrator ne me shume se ne nje shoqeri.
- 13.4 Administratori i shoqerise nuk mund te zgjidhet si administrator apo kryetar i keshillit te administrimit te shoqerive te kontrolluara (bija) dhe anasjelltas. Cdo emerim i bere ne kundershtrim me kete dispozitie eshte absolutisht i pavlefshem.
- 13.5 Administratori mund te shkarohet ne cdo kohe nga Keshilli Mbiqyres apo Asambleja e Pergjithshme. Ne rastin kur administratori ka maredhenie kontraktore me shoqerine, vadiet lidhur me shperblimin e tij rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.
- 13.6 Administratori eshte i riemrueshem, ai nuk mund te jete mbi moshen 65 vjec. Administratori qe mbush moshen 65 vjec, konsiderohet automatikisht i shkaruar.

Neni 14

Te drejtat dhe detyrat e Administratorit

- 14.1 Administratori perfaqeson shoqerine ne qarredhenie me te tregtet.
- 14.2 Administratori ka te gjitha fuqite ligjore te veprojne ne emer te shoqerise, pervec rasteve kur me ligji e ngarkohen Keshillit Mbiqyres.
- 14.3 Aktet me te cilat shoqeria merr persiper detyrimet ndaj te tretteve duhet te nenshkruhen nga Administratori ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit per kete akt.

5

- 14.4 Administratori perfaqeson ligjerisht shoqerine.
- 14.5 Administratori organizon, bashkerendon dhe drejton aktivitetin per administrimin e shoqerise:
 - Nenshkruan kontrata dhe marreveshje per te cilat eshte autorizuar nga Keshilli Mbiqyres.
 - Pergjigjet per aktivitetin e shoqerise dhe raportin te shoqerise per cdo tremujor.
 - Nenshkruan vendimet ne funksione te zbatimit te detyreve te caktuara per administrimin e shoqerise.
 - Organizon punen per hartimin e projekt-programit ekonomiko-financiar te shoqerise dhe pas miratimit nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregetise dhe Sipermarjtes (Asambleja e Pergjithshme) drejton punen per zbatimin e tij nga strukturat administrative te shoqerise.
- 14.6 Administratori eshte pergjegjes per ushtrimin e funksioneve te caktuara dhe per zbatimin e vendimeve te Keshillit Mbiqyres. Ai i paraqet Keshillit Mbiqyres raporte per administrimin e shoqerise ne intervale te rregullta, te pakten nje here ne tre muaj. Per me teper, i raporton Keshillit Mbiqyres per cdo rast tjeter te vecante.
- 14.7 Administratori eshte pergjegjes per hartimin e planit ekonomiko-financiar te shoqerise, pasqyrimin e gjendjes financiare vjetore dhe raportimin e tij ne Keshillin Mbiqyres. Brenda tre muajve nga mbyllja e vitit financiar te shoqerise, i paraqesin me shkrim Keshillit Mbiqyres per kontroll dhe verifikim raportin financiar vjetor te shoqerise te ekspertit kontabel dhe bilancin e shoqerise.
- 14.8 Maredheniet brenda shoqerise, funksionet dhe kriteret e vendete te punes, percaktohen me rregullore e funksionimit te brendshem te shoqerise, e cila miratohet nga Keshilli Mbiqyres.
- 14.9 Administratori cdo vit i propozon per miratim Keshillit Mbiqyres strukturën organizative te shoqerise dhe aparatit administrativ te saj.
- 14.10 Administratori emerohet dhe shkaron punonjesit e shoqerise ne perputhje me dispozitat qe rregullojne maredheniet e punes.

Neni 15

Ruajtja e sekretit

Anetaret e Keshillit Mbiqyres, Administratori, si dhe punonjesit e tjere te shoqerise, detyrohen te ruajne sekretin edhe pas largimit nga shoqeria per te dhenat qe kane karakter te brendshem te cilat jane percaktuar e miratur nga Administratori dhe ju jane bere te ditura punonjesve.

Neni 16

Marreveshjet ndermjet Shoqerise dhe Administratorëve ose nje anetari te Keshillit Mbiqyres.

- 16.1 Cdo marreveshje ndermjet Shoqerise dhe Administratorëve ose nje anetari te Keshillit Mbiqyres, qofte e drejtperdrejte ose jo e drejtpertdrejte duhet ti nenshtrohet autorizimit pamprakt te Keshillit Mbiqyres.
- 16.2 Percaktimi i mesiperme eshte i vlefshem edhe per marreveshjet ndermjet shoqerise dhe nje shoqerice tjeter, kur nje anetar i Keshillit Mbiqyres eshte edhe anetar i Keshillit Mbiqyres te nje shoqerice tjeter, me te cilen propozohet te lidhet marreveshja. Kjo nuk eshte e zabtueshme per marreveshjet qe kane te bejne me veprimtarite rrjedhese te shoqerise qe kryhen ne kushte normale.
- 16.3 Administratori ose nje anetar i Keshillit Mbiqyres i interesuar duhet te njoftoje Keshillin Mbiqyres per marreveshjet per te cilen zbatohen kerkesat e ketij viti statutit. Anetari i interesuar i Keshillit Mbiqyres nuk merr pjese ne votimin per dhenien e Autorizimit.

6

KREU VI

KONTROLLI, USHTRIMI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, FITIMET

Neni 17

Ekspertet kontabel te autorizuar

Kontrolli i shoqerise ushtrohet nga ekspertet kontabel te autorizuar te cilet emerohen per nje ushtrim financiar nga aksioneri i vetem (Asambleja e Pergjithshme). Shperblimi i ekspertëve perballohet nga vete shoqeria dhe do te behet ne baze te akte ligjore dhe nenligjore ne fuqi.

Neni 18

Plani ekonomik

Administratori, ne perputhje me aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi dhe udhezimet e lesuara nga Asambleja e Pergjithshme harton programin e zhvillimit ekonomiko-financiar dhe e paraqet per miratim ne Keshillin Mbiqyres. Pas miratimit, programi dergohet ne Asamblene e Pergjithshme (Ministrine e Zhvillimit Ekonomik, Tregetise dhe Sipermarjtes).

Neni 19

Ushtrimi financiar, inventari, llogarite vjetore

- 19.1 Ushtrimi financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron ne 31 Dhjetor te cdo viti.
- 19.2 Administratori do te mbajne nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe te veprimtarise se Shoqerise ne pajtim me kerkesat ligjore. Ne mbyllje te ushtrimit financiar, Administratori hartojne inventarin e pasurise ne kete date dhe llogarite vjetore per ushtrimin financiar. Administratori pergatitin gjithashtu edhe raportin e administrimit per gjendjen e shoqerise gjate ushtrimit financiar.

Neni 20

Rezultati i vitit ushtrimor dhe percaktimi i fitimit

- 20.1 Administratori hartojne bilancin e ushtrimit vjetor ne pajtim me kerkesat ligjore. 5 % e fitimeve qe rezultojne nga bilanci i vitit ushtrimor i miratur sipas parashikimeve te Ligjit hiqet per te krijuar rezerven e domosdoshme.
- 20.2 Kapitali nga fitimet per rezerven e domosdoshme nuk eshte e detyrueshme, kur kjo arrin 1/10 e heqatja themeltar te shoqerise.
- 20.3 Fitimi i mbetur shperndahet me vendim te Asamblese se Pergjithshme (Ministrise se Zhvillimit Ekonomik, Tregetise dhe Sipermarjtes).

Neni 21

Likuidimi dhe prishja.

- 21.1 Shoqeria konsiderohet e prishur me realizimin e ngjarjeve te parashikuara ne ligji. Ne rast prishjes Asambleja e Pergjithshme (Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregetise dhe Sipermarjtes), cakton nje ose me shume likuidatore, duke ju dhene atyre kompetencat perkatese.
- 21.2. Me vendim te Asamblese se Pergjithshme (Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregetise dhe Sipermarjtes), shoqeria gjithashtu mund te prishet ose te bashkohet me nje tjeter.

7

Neni 22

Asambleja e Pergjithshme

Te gjitha kompetencat e Asamblese se Pergjithshme te parashikuara nga ligji nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", qe nuk jane shprehur ne kete statut, ushtrohen nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregetise dhe Sipermarjtes me cilesine e aksionerit te vetem.

Neni 23

Per çfare nuk eshte shprehur ne kete statut, behet referimi ne dispozitat e legjislacionit ne fuqi per shoqerite tregtare.

MINISTRI



8